



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT KLINË

Nr. 111-313/18

Datë, 17.01.2018

Drejtori i DKA-së: Arben Limanaj

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212/ si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsim Parauniversitar 04/L-32, Udhëzimin Administrativ 07/2017 (MPMS), si dhe në normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit mësimor 06/2015 ,UA 05/2015 si dhe 34/2014, Drejtoria Komonale e Arsimit në Klinë shpall:

K O N K U R S

POZITA TË LIRA				
Nr.	Pozita	Shkolla	Orë mësimore	Fillon punën
1.	1 mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Motrat Qiriazit" Zajm	20	16.2.2018
2.	1 mësimdhënës/e për lëndën e matematikë	SHFMU "Atë Gjergj Fishta" Jagodë	15	Pas konkursit
3.	1 mësimdhënës/e nga lënda e gjuhës shqipe	SHFMU " Emin Duraku "	18	Pas konkursit
4.	1 mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Tre Dëshmorët" Resnik	20	Pas konkursit
5.	1 mësimdhënës/e nga lënda e artit	SHFMU " Ymer Berisha" Siqevë	12 orë (4 orë Siqevë, 4 Jashanicë e lartë, 4 Ujmirë)	21.2.2018
6.	1 psikolog/e shkolle	SHFMU "Ismet Raci " Klinë	40 orë pune	Pas konkursit

Z È V È N D È S I M E

Nr.	Pozita	Shkolla	Orë mësimore	Kohëzgjatja	Fillon punën
1.	1 mësues/e klase	SHFMU " Ismet Raci " Klinë	20	Deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lindjes	Pas konkursit
2.	1 mësues/e klase	SHFMU " Ali Krasniqi " Ujmirë	20	Deri në kthimin e punëtores nga pushimi i lindjes	Pas konkursit
3.	1 mësimdhënës/e nga lënda e gjuhës shqipe	SHMP " Fehmi Agani "	20	Deri në kthimin e punëtores nga pushimi	Pas konkursit

				i lindjes	
4.	I mësimdhënës/e nga lënda e gjuhës angleze	SHFMU "Tre Dëshmorët" Jashanicë	20	Deri më 31.08.2018	Pas konkursit

KUSHTET:

- Për këto vende të punës kërkohet përgatitja adekuate profesionale (Diploma e Fakultetit përkatës) konform udhëzimit administrativ 06/2015 mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe UA 05/2015.

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi

Të realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore

Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi

Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare

Të kontrollojë me rregull dhe të mbajë evidencën për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënësi, si dhe të jetë në gjendje t' i raportojë prindit apo kujdestarit të familjes

Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe aktiviteteve të tjera në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës

Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual

I punësuar i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë.

Psikologu i shkollës ka për detyrë të vlerësojë dhe interpretojë çështje që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të nxënësve.

Bashkëpunon me organet e shkollës dhe me të gjitha institucionet tjera profesionale.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Aplikacioni merret në DKA, duke ia bashkëngjitur dokumentet tjera si më poshtë:

- Diploma (certifikata) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vertetuar nga organi përkatës juridik – noteri.
- Certifikata e lindjes.
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Dokumenti i përvojës së punës në arsim (nëse ka).
- Licencë të mësimdhënies (nëse ka)
- Dokumentimi i trajnimeve arsimore (nëse ka).
- Vërtetimi se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për veprë penale.

UDHËZIM PËR APLIKIM:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga data e publikimit dhe mbyllet më datë 31.1.2018. Për datën dhe orën e testit dhe intervistimit ju njoftojmë menjëherë pas mbylljes së konkursit, në webfaqen e komunes dhe tabelen e shpalljeve. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me dokumentet e cekura më lart.

Vërejtje : Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen si dhe nuk kthehen pas konkurrimit.

